REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MALIQ**
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr.6754/1 Prot. Maliq, më 18.12.2025

**NJOFTIM**

**LËNDA:** Mbi zhvillimin e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak Maliq

**DREJTUAR: KËSHILLIT BASHKIAK MALIQ**
**KRYETARIT TË BASHKISË MALIQ**

**Të nderuar,**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"* datë 17.12.2015, i ndryshuar, neni 53, *"Funksionimi i këshillit bashkiak"*, pika 4 dhe 5, neni 56 *"Kryetari i këshillit bashkiak"* pika 2 gërma "a", dhe në zbatim të Rregullores së Këshillit Bashkiak Maliq miratuar me vendim këshilli nr.24, datë 12.03.2020, *"Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Bashkisë Maliq"* ju njoftojmë se mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak Maliq do të zhvillohet në sallën e mbledhjeve të këshillit ditën e mërkurë, **më datë 24.12.2025, ora 10:00** me këtë,

Rend Dite:

1.Hapja e mbledhjes (korumi, miratimi i rendit të ditës, vendimet e mbledhjes së kaluar);
2.Deklarimi i konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimmarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 31.10.2025 dhe 26.11.2025.
4.P-V "Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë Maliq, penalitetet për shkeljet apo kundravajtjet administrative për vitin 2026";
5.P-V "Për miratimin e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të adminsitratës së Bashkisë Maliq dhe struktura të tjera për vitin 2026";
6.P-V "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Maliq për vitin 2026";
7.P-V"Për miratimin e listës të investimeve prioritare të Bashkisë Maliq për vitin 2026";
8.P-V "Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm përfundimtar për vitet 2026-2028 ";
9.P-V "Për miratimin e kalendarit të programit buxhetor afatmesëm 2027-2029 dhe vjetor 2026";
10.P-V "Për miratimin e bursave të arsimit të mesëm të përgjithshëm dhe arsimit profesional të vitit shkollor 2025-2026";
11. P-V "Për miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin nëntor 2025";
12.P-V "Për dhënie ndihme financiare për familje në nevojë";
13. P-V "Për dhënie ndihme financiare për familjen e z.G.B banues në fashtin Zvirinë NJ.A Pirg, banesa e të cilit u shemb si pasojë e përmbytjes së datës 20.11.2025";
14.Diskutime të tjera.

Të tjera pika informuese:

- Njoftim për inventarizimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të bashkisë Maliq.

- Informacion lidhur me përmbytjet e ndodhura gjatë muajit nëntor në territorin e bashkisë Maliq.

**Shënim:**Mbledhjet e Komisioneve të Këshillit do të mbahen ditën e martë me datë 23.12.2025 nga ora 10:00-13:00 si më poshtë:

**Komisioni i Mirëqënies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, Drejtave të Njeriut.** Pikat 11 dhe 12 e rendit të ditës:
z.Faslli Zholli, znj.Gentiana Drabo, z.Armando Dautllari, z.Plator Çollaku, znj.Marjeta Xhelollari

**Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, dhe Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, Mbikqyrjes Financiare.**Pikat: 4, 5, 6, 7, 8, 9 e rendit të ditës:
z.Petrit Kupe, znj.Pranvera Begolli, znj.Marianthi Avrami, znj.Eglantina Balli, z.Andonaq Risto.

**Komisioni i Arsimit, Sporteve dhe Çlodhjes.** Pika 10 e rendit të ditës:
znj.Neresida Shindo, znj.Gentina Drabo, znj.Daniela Ibrahim, z.Lulëzim Hoxhaj, z.Faslli Zholi.

**Komisioni i Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Rehabilitimit.** Pika 13 e rendit të ditës: z.Dritan Çami, z.Ilia Xhuti, znj.Floreta Zaçe, z.Yllson Ibrahimllari, Z.Almir Elezi.

*Ju faleminderit!*

**KRYETARI I KËSHILLIT**

**Ornildi DEMOLLARI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ